



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0529

OSHP : 2026/0539

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) KRASNIQI SERVICE SH.P.K., dhe (OE) SEFERI - MONT SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, të Komuna e Pejës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Mirëmbajtja dhe Servisimi i automjeteve (veturave) zyrtare të SHCK-së në Komunën e Pejës me numër të prokurimit 635-26-318-2-1-1, me 01.09.2026, mori:

Vendim

1. **Aprovohen**, si pjesërisht të bazuara ankesat e OE KRASNIQI SERVICE SH.P.K., me nr. 2026/0529, e datës 24.07.2026, dhe ankesa e OE SEFERI - MONT SH.P.K., me nr. 2026/0539, e datës 27.07.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit Mirëmbajtja dhe Servisimi i automjeteve (veturave) zyrtare të SHCK-së në Komunën e Pejës me numër të prokurimit 635-26-318-2-1-1.
2. **Anulohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të Komuna e Pejës, ndërsaq aktiviteti i prokurimit Mirëmbajtja dhe Servisimi i automjeteve (veturave) zyrtare të SHCK-së në Komunën e Pejës me numër të prokurimit 635-26-318-2-1-1 kthehet në **Rivlerësim**.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik KRASNIQI SERVICE SH.P.K., SEFERI - MONT SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 03.02.2026, Komuna e Pejës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Mirëmbajtja dhe Servisimi i automjeteve (veturave) zyrtare të SHCK-së në Komunën e Pejës me numër të prokurimit 635-26-318-2-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 150,000.00 €.

Me 14.07.2026 AK Komuna e Pejës, ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 ku është rekomanduar për kontratë OE “Gentian Sakaj B.I.”.

Me 17.07.2026, OE KRASNIQI SERVICE SH.P.K., dhe OE SEFERI- MONT SH.P.K., kanë parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 20.07.2026 Autoriteti Kontraktues ka publikuar vendimin përmes të cilit refuzohen si të pa bazuara ankesat e të dy Operatorëve Ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me 24.07.2026, OE KRASNIQI SERVICE SH.P.K., ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0529/2026 ndërsa me datë 27.07.2026 OE SEFERI- MONT SH.P.K., ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0539/2026.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0529/2026 dhe ankesa nr. 0539/2026 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues KRASNIQI SERVICE SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Ky është Vendimi i katërt, i datës 14.07.2026, i marrë nga Autoriteti Kontraktues (AK) në kuadër të kësaj procedure të prokurimit, si dhe refuzimi i kërkesës për rishqyrtim.

1. Vendimi fillestar i Autoritetit Kontraktues

1.1. Autoriteti Kontraktues fillimisht e kishte rekomanduar për dhënie të kontratës Operatorin Ekonomik (OE) **SEFERI MONT**.

1.2. Ne kemi pranuar Letrën Standarde për Tenderuesin e Pasuksesshëm.

1.3. Operatori Ekonomik **Gentian Sakaj B.I.** ishte eliminuar për shkak të mosplotësimit të kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe Formularit të Tenderit (FDT).

2. Anulimi i procedurës së prokurimit

Pas qasjes në dokumentacionin e tenderit, kemi konstatuar se OE i rekomanduar kishte gabime aritmetike dhe kishte ndërhyrë në paramasë. Autoriteti Kontraktues, me vendimin e datës 26.03.2026, ka anuluar procedurën e prokurimit.

Ne kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim ndaj këtij vendimi, mirëpo kërkesa jonë është refuzuar nga AK.

3. Ankesa në OSHP dhe vendimi për rivlerësim

Pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, kemi ushtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).

Me vendimin nr. 216/26, OSHP ka aprovuar ankesën tonë dhe ka detyruar Autoritetin Kontraktues që lëndën ta kthejë në rivlerësim, duke konstatuar se anulimi i procedurës ishte bërë në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

Rrjedhimisht, sipas Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0216, të datës 04.05.2026, AK është obliguar të kryejë rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë.

3.1. OE **SEFERI MONT** nuk ka ushtruar ankesë as ndaj vendimit të AK-së dhe as në OSHP.

3.2. OE **Gentian Sakaj B.I.** gjithashtu nuk ka ushtruar ankesë as ndaj vendimit të AK-së dhe as në OSHP.

4. Vendimi i AK-së gjatë rivlerësimit

Gjatë procesit të rivlerësimit, me vendimin e datës 13.05.2026, Autoriteti Kontraktues ka eliminuar të gjithë operatorët ekonomikë, përfshirë edhe ofertën tonë, duke pretenduar se nuk përmbushnim një kërkesë të FDT-së, e cila në fakt nuk ka ekzistuar fare në dokumentacionin e tenderit.

4.1. Ndërkohë, ofertat e OE **SEFERI MONT** dhe **Gentian Sakaj B.I.** (i rekomanduari me vendimin e fundit) janë eliminuar, duke u dhënë arsyetimet përkatëse nga AK.

4.2. Asnjëri prej këtyre operatorëve ekonomikë nuk ka ushtruar ankesë ndaj vendimit të AK-së të datës 13.05.2026, as pranë AK-së dhe as në OSHP.

Ne kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim ndaj këtij vendimi, por edhe kjo kërkesë është refuzuar nga Autoriteti Kontraktues.

Më pas, kemi paraqitur ankesë në OSHP si pala e vetme me interes juridik dhe si operator ekonomik i përgjegjshëm.

Me vendimin e datës 22.06.2026, nr. OSHP 2026/0336, OSHP ka aprovuar ankesën tonë dhe ka detyruar Autoritetin Kontraktues që lëndën ta kthejë përsëri në rivlerësim, duke urdhëruar

njëkohësisht:

4. Urdhërohet Autoriteti Kontraktues – Komuna e Pejës që, brenda afatit prej pesë (5) ditësh kalendarike, ta njoftojë OSHP-në lidhur me zbatimin e Vendimit të OSHP-së nr. PSh.2026/0216, të datës 04.05.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Mirëmbajtja dhe Servisimi i automjeteve (veturave) zyrtare të SHCK-së në Komunën e Pejës”**, me numër të prokurimit 635-26-318-2-1-1.

5. Mosrespektimi i kësaj urdhërese brenda afatit prej pesë (5) ditësh kalendarike do ta detyrojë Panelin Shqyrtues të veprojë në përputhje me nenin 131 të LPP-së dhe, njëkohësisht, të kërkojë nga KRPP anulimin e licencës së menaxherit të prokurimit të AK-së – Komuna e Pejës, në përputhje me nenin 25, paragrafët 8 dhe 9 të LPP-së.

Megjithatë, më datë 14.07.2026, në kundërshtim me Vendimin e OSHP-së të datës 22.06.2026, si dhe në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe nenin 40 të Rregullores për Prokurimin Publik nr. 001/2022, Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për dhënie të kontratës një Operator Ekonomik, të cilin, në të gjitha vendimet paraprake, vetë e kishte vlerësuar si operator të papërgjegjshëm dhe jo të përgjegjshëm.

Ky Operator Ekonomik, për më tepër, është pajtuar vazhdimisht me vlerësimet dhe konstatimet e Autoritetit Kontraktues, duke mos ushtruar asnjë mjet juridik kundër tyre.

Në vijim paraqesim vetëm disa nga arsyet të cilat vetë Autoriteti Kontraktues i kishte evidentuar në vendimet paraprake për eliminimin e këtij Operatori Ekonomik:

[Vendosen këtu imazhet/dëshmitë përkatëse.]

Pra, AK-ja, vetëm e vetëm për të mos na rekomanduar neve për dhënie të kontratës, në kundërshtim me LPP-në dhe në kundërshtim të plotë me Vendimet e OSHP-së, ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është plotësisht i papërgjegjshëm dhe, njëkohësisht, tashmë është palë pa interes juridik, pasi i njëjti është pajtuar me eliminimin e ofertës së tij në të gjitha vendimet e AK-së dhe Vendimet e OSHP-së të cekura më sipër.

Kërkojmë nga OSHP që ta aprovojë **ANKESËN** tonë si të bazuar, ta detyrojë AK-në që lëndën ta kthejë në rivlerësim dhe, pas rivlerësimit, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe dokumentacionin e tenderit, të na rekomandojë për dhënie të kontratës si Operator Ekonomik i përgjegjshëm dhe i përgjegjshëm ekonomikisht.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues SEFERI- MONT SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi Ankimor 1

Pretendim lidhur me mosplotësimin e kriterit të përvojës së ngjashme nga OE Gentian Sakaj B.I. Operatori Ekonomik Gentian Sakaj B.I. nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe, si rrjedhojë, rekomandimi i tij për dhënie të kontratës është në kundërshtim me nenet 65 dhe 66 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar. Në Dosjen e Tenderit është përcaktuar qartë:

Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për projekte të ngjashme (servisim i automjeteve) në vlerë minimale prej 130,000.00 euro gjatë 3

(tri) viteve të fundit, duke llogaritur periudhën nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Në rast të grupit të operatorëve ekonomikë, udhëheqësi i grupit duhet të ketë realizuar së paku 50% të vlerës së kërkuar të kontratave të ngjashme.

Dëshmia 1: Operatori Ekonomik është obliguar të dorëzojë listën e kontratave të realizuara sipas Aneksit të Dosjes së Tenderit, duke specifikuar titullin e kontratës, vlerën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe ti bashkëngjisë referencat ose procesverbalet që dëshmojnë kryerjen e punëve. Për kontratat e realizuara në sektorin privat kërkohet gjithashtu dëshmi e pagesave përmes bankës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE i propozuar për kontratë rezulton se ai nuk arrin të dëshmojë kontrata të natyrës së ngjashme në vlerën minimale të kërkuar prej 130,000.00 euro, siç kërkohet nga Dosja e Tenderit. Autoriteti Kontraktues vetë ka konstatuar se kontrata me Policinë e Kosovës, në vlerë prej 4,780.00 euro, nuk mund të konsiderohet kontratë e natyrës së njëjtë me objektin e prokurimit dhe, rrjedhimisht, nuk mund të llogaritet në përmbushjen e kriterit të përvojës së ngjashme. Po ashtu, kontrata me Komunën e Dragashit nuk është në përputhje të plotë me kërkesat e Dosjes së Tenderit, pasi nuk dëshmohet se ka qenë e përfunduar me sukses brenda periudhës relevante të kërkuar. Duke pasur parasysh se hapja e ofertave është zhvilluar më 16.03.2026, kjo kontratë nuk mund të konsiderohet si kontratë e përfunduar dhe e realizuar në kuptim të kërkesës së Dosjes së Tenderit.

Aud AUTO SHTEPIA SE341CE. SEFERIMONT. PEJË-KOSOVË. Tel. 044/125-493

Vetë lista e kontratave të dorëzuara nga OE tregon se vlera e kontratave të pretenduara si të ngjashme arrin në 92,174.65 euro. Nëse nga kjo shumë zbritet vlera prej 4,780.00 euro e kontratës me Policinë e Kosovës, e cila nuk konsiderohet kontratë e natyrës së njëjtë, atëherë vlera e mbetur është dukshëm më e ulët se pragu minimal prej 130,000.00 euro i kërkuar nga Dosja e Tenderit.

Për rrjedhojë, OE Gentian Sakaj B.I. nuk ka arritur të dëshmojë përvojën e kërkuar profesionale dhe teknike sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe nuk i plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues. Në bazë të nenit 65 të LPP-së, operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë kapacitetin e tyre teknik dhe profesional në përputhje me kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, ndërsa sipas nenit 66 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues është i obliguar të vlerësojë dhe verifikojë në mënyrë rigorozë përmbushjen e këtyre kërkesave para dhënies së kontratës. Duke qenë se OE i propozuar për kontratë nuk ka dëshmuar vlerën minimale të kontratave të ngjashme prej 130,000.00 euro dhe nuk ka përmbushur plotësisht kërkesat e Dosjes së Tenderit, rekomandimi për shpërblim të kontratës është i pabazuar në kriteret e përcaktuara dhe përbën shkelje të dispozitave të LPP-së dhe të parimeve themelore të trajtimit të barabartë, transparencës dhe konkurrencës së ndershme në procedurat e prokurimit publik. Prandaj, kërkojmë që ankesa jonë të aprovohet, të anulohet vendimi për dhënie të kontratës ndaj OE Gentian Sakaj B.I. dhe Autoriteti Kontraktues të rivlerësojë ofertat në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

Pretendimi Ankimor 2

Lidhur me kontratën e paraqitur nga OE Gentian Sakaj B.I. Po ashtu, OE Gentian Sakaj B.I., si operator ekonomik i propozuar për dhënie të kontratës, ka paraqitur si dëshmi një kontratë e cila është nënshkruar nga i njëjti person në cilësinë e të dyja palëve kontraktuese, përkatësisht nga z. Gentian Sakaj si pronar i biznesit dhe, njëkohësisht, si pala tjetër kontraktuese.

Audi AUTO SHTEPIA SERVICE. SEFERIMONT. PEJË-KOSOVË. Tel. 044/125-493

Një dokument i tillë nuk mund të konsiderohet kontratë e vlefshme për qëllime të dëshmimit të përvojës së ngjashme, pasi mungon elementi themelor i marrëdhënies kontraktore ndërmjet dy palëve të ndryshme. Në këto rrethana, kemi të bëjmë me një dokument të nënshkruar nga i njëjti person me vetveten, i cili nuk krijon një raport juridik kontraktor dhe, për rrjedhojë, nuk mund të shërbejë si dëshmi e vlefshme për përmbushjen e kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Për më tepër, edhe vetë Autoriteti Kontraktues, gjatë procesit të vlerësimit, ka konstatuar se kjo kontratë nuk mund të merret në konsideratë, duke e përjashtuar atë nga vlerësimi i përvojës së OE-së. Ky konstatim vërteton se dokumenti në fjalë nuk është në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara për dëshmimin e kontratave të ngjashme.

Rrjedhimisht, pranimi ose marrja në konsideratë e kësaj kontrate do të ishte në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit, si dhe me nenin 65 dhe nenin 66 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, të cilat obligojnë operatorët ekonomikë të dëshmojnë përmbushjen e kriterëve të kualifikimit me dokumente të vlefshme, autentike dhe të besueshme. Një kontratë e nënshkruar nga i njëjti person në të dyja anët nuk mund të konsiderohet provë e besueshme për përvojë të mëparshme dhe, si e tillë, nuk duhet të prodhojë asnjë efekt juridik në procedurën e prokurimit.

Pretendimi Ankimor 3

Pretendimi Ankimor - Mosplotësimi i Formularit për Vazhdimin e Validitetit të Ofertës nga OE KRASNIQI SERVICE

Operatori Ekonomik KRASNIQI SERVICE nuk i ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në nenin 59 dhe nenin 72 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (LPP), si dhe ka vepruar në kundërshtim me Udhëzuesin Nr. 002/2024 për Plotësim-Ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, konkretisht nenin 10 - Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve.

Gjatë procedurës së prokurimit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar nga operatorët ekonomikë vazhdimin e validitetit të ofertës dhe të sigurimit të ofertës, duke përcaktuar qartë se operatorët ekonomikë duhet ta plotësojnë PJESËN C – Formulari për Vazhdimin e Validitetit.

Megjithëse OE KRASNIQI SERVICE e ka dorëzuar formularin në fjalë, ai nuk është plotësuar në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat ligjore, duke paraqitur mangësi thelbësore që e bëjnë ofertën administrativisht të papërgjegjshme.

Konkretisht:

Audi AUTO SHTEPIA SERVICE. SEFERIMONT. PEJË-KOSOVË. Tel. 044/125-493

Në pikën 5 të Formularit për Vazhdimin e Validitetit, operatori ekonomik nuk e ka deklaruar shumën fikse të sigurimit të ofertës prej 15,000.00 Euro, e cila përfaqëson 10% të vlerës së kontratës, sipas kërkesës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit dhe për periudhën e kërkuar prej 25 muajve.

Po ashtu, në pikën 6 të të njëjtit formular, OE KRASNIQI SERVICE nuk e ka deklaruar nacionalitetin e tij, ndonëse kjo fushë është pjesë obligative e formularit standard dhe kërkohet të plotësohet nga operatori ekonomik.

Këto mangësi nuk mund të konsiderohen si lëshime formale apo gabime të natyrës teknike, pasi ato kanë të bëjnë me mosplotësimin e formularit standard, i cili është dokument administrativ i detyrueshëm dhe duhet të dorëzohet i plotësuar sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Për më tepër, Udhëzuesi Nr. 002/2024, në pjesën që rregullon trajtimin e formularëve gjatë vlerësimit të tenderëve, përcakton qartë se:

Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.

Kjo dispozitë nuk i lë Autoritetit Kontraktues hapësirë për të kërkuar sqarime apo plotësime të mëvonshme kur formulari nuk është plotësuar sipas kërkesave, pasi një veprim i tillë do të ishte në kundërshtim me parimet e barazisë së trajtimit, transparencës dhe konkurrencës së drejtë, të garantuara me Ligjin për Prokurimin Publik.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar që ofertën e OE KRASNIQI SERVICE ta shpallte administrativisht të papërgjegjshme dhe ta refuzonte, pa kërkuar informacione ose plotësime shtesë, ashtu siç kërkojnë dispozitat e LPP-së dhe Udhëzuesi për Prokurimin Publik.

Prandaj, bazuar në nenin 59 dhe nenin 72 të LPP-së, si dhe në Udhëzuesin Nr. 002/2024, kërkojmë që të konstatohet se OE KRASNIQI SERVICE nuk ka përmbushur kërkesat administrative të Dosjes së Tenderit dhe, për pasojë, oferta e tij duhet të shpallet e papërgjegjshme dhe të përjashtohet nga procedura e mëtejshme e vlerësimit.

Dhe

Si mbështetje të këtij pretendimi bashkëngjisim fotografitë dhe dokumentacionin përkatës, të cilat dëshmojnë qartë mangësitë e mësipërme.

Pretendimi Ankimor 3.1.

OE KRASNIQI SERVICE nuk ka përmbushur kërkesat administrative të Dosjes së Tenderit, ndërsa Autoriteti Kontraktues ka zbatuar në mënyrë selektive legjislacionin e prokurimit publik duke e shpallur ofertën e tij të përgjegjshme në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Udhëzuesin Nr. 002/2024. Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, Dosjen e Tenderit dhe Udhëzuesin Nr. 002/2024 për Plotësim-Ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, duke e konsideruar të përgjegjshme ofertën e Operatorit Ekonomik KRASNIQI SERVICE, ndonëse ky operator ekonomik nuk ka përmbushur një nga kërkesat administrative të përcaktuara nga vetë Autoriteti Kontraktues.

Audi 9/4 AUTO SHTEPIA SERVICE. SEFERIMONT. PEJË-KOSOVË. Tel. 044/125-493

Nga dokumentacioni i administruar në këtë procedurë rezulton se Autoriteti Kontraktues, përmes njoftimit zyrtar drejtuar të gjithë operatorëve ekonomikë lidhur me vazhdimin e validitetit të ofertave, ka kërkuar shprehimisht që secili operator ekonomik:

"...duhet ta plotësoni Formularin C, i cili gjendet në Dosjen e Tenderit të këtij aktiviteti të prokurimit, i cili duhet të nënshkruhet dhe të vuloset dhe ta përcillni te Autoriteti Kontraktues bashkë me sigurimin e ri të tenderit..."

Nga kjo kërkesë rezulton qartë se plotësimi i Formularit C nuk ka qenë fakultativ apo formal, por një kërkesë administrative e detyrueshme, e vendosur nga vetë Autoriteti Kontraktues si kusht për vazhdimin e validitetit të ofertës. Megjithatë, nga dokumentacioni i ofertës së Operatorit Ekonomik KRASNIQI SERVICE konstatohet se Formulari C nuk është plotësuar sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit. Konkretisht:

Audi 10/4 AUTO SHTEPIA SERVICE SEFERIMONT. PEJË-KOSOVË. Tel. 044/125-493

Në pikën 5 të formularit nuk është deklaruar shuma e sigurimit të ekzekutimit, ndonëse formulari kërkon shprehimisht deklarimin e vlerës ose përqindjes së sigurimit; në pikën 6 nuk është deklaruar nacionaliteti i operatorit ekonomik, edhe pse kjo fushë është pjesë përbërëse dhe obligative e formularit standard.

Mosplotësimi i këtyre rubrikave nuk mund të konsiderohet si gabim teknik apo lëshim formal, pasi bëhet fjalë për mosplotësim të një formulari standard administrativ, të cilin vetë Autoriteti Kontraktues kishte kërkuar që të plotësohej, të nënshkruhej dhe të vulosej.

Për më tepër, Udhëzuesi Nr. 002/2024 për Plotësim-Ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, në tabelën për trajtimin e dokumenteve administrative gjatë procesit të vlerësimit të ofertave, përcakton qartë dhe në mënyrë imperative se:

"Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm."

Kjo dispozitë nuk është rekomanduese, por urdhëruese, dhe nuk i lë Autoritetit Kontraktues asnjë diskrecion për të toleruar formularë të paplotësuar apo për të lejuar vazhdimin e procedurës me një operator ekonomik që nuk ka përmbushur kërkesat administrative.

Rrjedhimisht, në momentin kur Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se Formulari C i Operatorit Ekonomik KRASNIQI SERVICE nuk ishte plotësuar sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit, ai kishte vetëm një detyrim ligjor: refuzimin e ofertës së këtij operatori ekonomik, pa kërkuar informacion shtesë dhe pa e trajtuar ofertën si të përgjegjshme.

Përkundër kësaj, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në mënyrë selektive, duke mos zbatuar të njëjtin standard ligjor ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë dhe duke favorizuar Operatorin Ekonomik KRASNIQI SERVICE, ndonëse oferta e tij nuk i plotësonte kërkesat administrative të Dosjes së Tenderit.

Një veprim i tillë përbën shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili obligon Autoritetin Kontraktues të vlerësojë vetëm ofertat që përmbushin kërkesat e Dosjes së Tenderit, si dhe të nenit 72 të LPP-së, që rregullon trajtimin e dokumentacionit gjatë procesit të vlerësimit.

Po ashtu, ky veprim cenon rëndë parimet themelore të prokurimit publik, përkatësisht: parimin e ligjshmërisë; parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit; parimin e transparencës; parimin e konkurrencës së ndershme.

Autoriteti Kontraktues nuk mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë plotësimin e një formulari administrativ si kusht të detyrueshëm të procedurës dhe, njëkohësisht, të shpallë fitues një operator ekonomik që nuk e ka plotësuar atë formular sipas kërkesave të përcaktuara nga vetë Autoriteti Kontraktues. Një interpretim i tillë do të legjitimonte mosrespektimin e kushteve të Dosjes së Tenderit dhe do të cenonte rëndë sigurinë juridike dhe integritetin e procedurës së prokurimit.

Për rrjedhojë, është e qartë se OE KRASNIQI SERVICE nuk i ka përbushur kërkesat administrative të Dosjes së Tenderit, ndërsa Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Udhëzuesin Nr. 002/2024, duke e konsideruar ofertën e tij si të përgjegjshme.

Audi 11/4 AUTO SHTEPIA SERVICE. SEFERIMONT. PEJË-KOSOVË. Tel. 044/125-493

Prandaj, i propozojmë Panelit Shqyrtues të Organit Shqyrtues të Prokurimit që të konstatojë se Autoriteti Kontraktues ka zbatuar gabimisht dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe Udhëzuesit Nr. 002/2024, të konstatojë se Operatori Ekonomik KRASNIQI SERVICE nuk ka përbushur kërkesat administrative të Dosjes së Tenderit dhe, si pasojë, oferta e tij të shpallet e papërgjegjshme.

Për më tepër, duke qenë se kjo shkelje përbën një nga shkeljet materiale të evidentuara në këtë procedurë dhe në lidhje me pretendimet e tjera ankimore, kërkojmë që OSHP të anulojë aktivitetin e prokurimit në tërësi, pasi procedura është zhvilluar në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik dhe nuk garanton trajtim të barabartë, transparencë dhe konkurrencë të ndershme ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Pretendimi Ankimor 4.

Operatori Ekonomik KRASNIQI SERVICE nuk i ka përbushur kërkesat e përcaktuara në Formularin e Dosjes së Tenderit (FDT), pasi oferta e tij nuk është në përputhje me kërkesat administrative dhe teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues.

Konkretisht, OE KRASNIQI SERVICE ka dorëzuar vetëm një deklaratë lidhur me pikën 9.1.5 të FDT-së, mirëpo nuk ka dorëzuar Aneksin 1 - Specifikimet Teknike të Detyrueshme, i cili ishte pjesë integrale e Dosjes së Tenderit dhe dokument i detyrueshëm për tu plotësuar, nënshkruar, vulosur dhe skanuar nga secili operator ekonomik.

Në Dosjen e Tenderit është përcaktuar qartë se Aneksi 1 - Specifikimet Teknike të Detyrueshme duhet të printohet, të plotësohet sipas kërkesave, të nënshkruhet, të vuloset dhe të dorëzohet si pjesë e ofertës.

Ky aneks nuk është thjesht një dokument informues, por përmban kërkesa teknike dhe detyrime kontraktuale që operatori ekonomik duhet ti pranojë dhe ti marrë përsipër në mënyrë të qartë dhe të pakushtëzuar.

Në këtë aneks, ndër të tjera, është përcaktuar se: Operatorët Ekonomikë duhet të njihen me specifikat e veprimtarisë së Komunës së Pejës, në mënyrë që qasja ndaj realizimit të kontratës të jetë adekuate. Automjetet e Komunës së Pejës janë në funksion të vazhdueshëm dhe përdoren për nevoja operative të institucionit, për çka ekziston nevoja që servisimi të realizohet sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues. Servisimi dhe liferimi duhet të kryhen në autoparkun e

Komunës së Pejës, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e lëshimit të Urdhërblërjes, dhe ky obligim duhet të respektohet gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

Megjithatë, OE KRASNIQI SERVICE nuk e ka dorëzuar Aneksin 1, rrjedhimisht nuk ka deklaruar dhe nuk ka pranuar në mënyrë formale obligimin se gjatë periudhës së kontratës prej 24 muajsh do ta realizojë servisimin dhe liferimin brenda afatit maksimal prej 10 ditësh nga data e pranimi të çdo Urdhërblërjeje.

Po ashtu, duke mos e dorëzuar Aneksin 1 të nënshkruar dhe të vulosur, OE nuk ka konfirmuar pranimin e specifikimeve teknike, të listës së automjeteve dhe kamionëve të Autoritetit Kontraktues, si dhe të gjitha kërkesave teknike të përcaktuara në këtë aneks.

Audi 12/4 AUTO SHTEPIA SERVICE. SEFERIMONT. PEJË-KOSOVË. Tel. 044/125-493

Mosdorëzimi i këtij dokumenti përbën mosplotësim të një kërkesë të detyrueshme të Dosjes së Tenderit, e cila nuk mund të zëvendësohet me një deklaratë të përgjithshme, pasi specifikimet teknike përbëjnë bazën mbi të cilën Autoriteti Kontraktues vlerëson përputhshmërinë e ofertës me kërkesat e procedurës së prokurimit.

Për më tepër, një veprim i tillë është në kundërshtim me nenin 19 - Specifikimet Teknike të Rregullores për Prokurimin Publik (Versioni i Konsoliduar), i cili kërkon që operatorët ekonomikë të dëshmojnë përputhshmërinë e ofertës së tyre me specifikimet teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues.

Për rrjedhojë, oferta e OE KRASNIQI SERVICE nuk është në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe nuk dëshmon pranimin e plotë të specifikimeve teknike të detyrueshme. Si rezultat, oferta duhet të konsiderohet e papërgjegjshme dhe të eliminohet nga procedura e mëtejshme e vlerësimit, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, Rregullores për Prokurimin Publik dhe kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Për këtë pretendim bashkëngjisim si provë Dosjen e Tenderit, Aneksin 1 - Specifikimet Teknike të Detyrueshme, si dhe dokumentacionin e ofertës së OE KRASNIQI SERVICE, nga i cili vërtetohet qartë se ky dokument i detyrueshëm nuk është dorëzuar, nënshkruar dhe vulosur sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues.

Pretendimi Ankimor 5.

Autoriteti Kontraktues, me vendimin e datës 26.03.2026, kishte anuluar aktivitetin e prokurimit në fjalë. Ky vendim është marrë si rezultat i konstatimit të gabimeve në dokumentacionin e tenderit, konkretisht në Paramasën dhe Parallogarinë, të cilat gabime janë pranuar edhe nga vetë Autoriteti Kontraktues.

Nga dokumentet e siguruara përmes qasjes në dokumente publike rezulton se ekziston një komunikim zyrtar përmes postës elektronike ndërmjet zyrtarëve të Autoritetit Kontraktues dhe zyrtares Znj. Shpresa Bukleta Gjuka, i datës 25.03.2026, në të cilin konfirmohet qartë se në Paramasën dhe Parallogarinë kanë ekzistuar gabime materiale.

Ky komunikim përbën provë të pakontestueshme se vetë Autoriteti Kontraktues ka pranuar se dokumentacioni i tenderit nuk ishte hartuar në mënyrë të saktë, pasi kishte mospërputhje ndërmjet Paramasës dhe Parallogarisë të publikuar në platformën elektronike të prokurimit dhe dokumentacionit të dorëzuar në formë fizike.

Për rrjedhojë, është e paqëndrueshme dhe në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike që Autoriteti Kontraktues, pasi ka konstatuar dhe pranuar këto gabime, të ndërmarrë më pas veprime që bien ndesh me vendimin dhe konstatimet e veta.

Për më tepër, nga dokumentacioni rezulton se në Pjesën D - KarrocERIA, konkretisht në pozicionin nr. 12 - Sensorët e Parkimit, janë përfshirë automjete për të cilat kjo pajisje nuk ekziston fare. Pra, jo të gjitha automjetet e listuara në Paramasë janë të pajisura me sensorë parkimi, gjë që dëshmon qartë se Paramasa dhe Paralogaria nuk janë përgatitur mbi të dhëna të sakta teknike.

Duke u bazuar në këtë gjendje faktike, ne si operatori ekonomik kemi vepruar me përgjegjësi profesionale, duke mos vendosur çmim për pozicionet që objektivisht nuk mund të ofertoheshin, por duke shënuar "N/A", pasi nuk ekzistonte mundësia reale për të ofertuar një shërbim apo pjesë që nuk aplikohet për automjetet përkatëse.

Audi 13/4 AUTO SHTEPIA SERVICE. SEFERIMONT. PEJË-KOSOVË. Tel. 044/125-493

Madje, nga komunikimet e mëvonshme të Autoritetit Kontraktues rezulton se ky pozicion në fakt kishte të bënte vetëm me dy automjete, gjë që dëshmon edhe një herë se Paramasa dhe Paralogaria kanë qenë të pasakta dhe kanë krijuar paqartësi serioze për operatorët ekonomikë gjatë përgatitjes së ofertave.

Në këto rrethana, kur vetë Autoriteti Kontraktues ka pranuar ekzistimin e gabimeve materiale dhe kur këto gabime ndikojnë drejtpërdrejt në përgatitjen dhe krahasueshmërinë e ofertave, vazhdimi i procedurës së prokurimit cenon parimet themelore të transparencës, barazisë së trajtimit, proporcionalitetit dhe konkurrencës së drejtë, të garantuara me Ligjin për Prokurimin Publik.

Për këtë arsye, konsiderojmë se janë plotësuar kushtet ligjore për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, pasi dokumentacioni i tenderit përmbante gabime substanciale që kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në përgatitjen e ofertave dhe në trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

Prandaj, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullores për Prokurimin Publik, të respektojë konstatimet dhe vendimet e veta të mëparshme, të marrë në konsideratë provat e bashkëngjitura dhe të anulojë aktivitetin e prokurimit, pasi ekzistojnë fakte dhe prova të mjaftueshme që dëshmojnë se Paramasa dhe Paralogaria kanë qenë të pasakta dhe kanë cenuar zhvillimin e rregullt dhe të ligjshëm të procedurës.

Në mbështetje të këtij pretendimi bashkëngjisim komunikimet elektronike të datës 25.03.2026, dokumentet e siguruara përmes qasjes në dokumente publike, si dhe provat përkatëse që dëshmojnë gabimet në Paramasë dhe Paralogari.

Në komunikimin zyrtar të publikuar në platformën e-Prokurimit, mund të konstatohet qartë se zyrtarja e Autoritetit Kontraktues, Znj. Shpresa Bukleta Gjuka, pranon ekzistimin e gabimeve në dokumentacionin e tenderit, duke kërkuar falje për operatorët ekonomikë dhe duke deklaruar se "ka ndodhur një gabim teknik në Paramasë dhe Paralogari."

Ky pranim përbën provë të drejtpërdrejtë se mangësitë në dokumentacion nuk janë pretendime të pabazuara të operatorëve ekonomikë, por janë pranuar nga vetë Autoriteti Kontraktues.

Rrjedhimisht, ky fakt dëshmon se Paramasa dhe Paralogaria nuk kanë qenë të hartuara në mënyrë të saktë dhe kanë përmblotur gabime që kanë ndikuar në përgatitjen e ofertave dhe në zhvillimin e rregullt të procedurës së prokurimit.

Për këtë arsye, kërkojmë që ky komunikim zyrtar të vlerësohet si provë relevante në këtë procedurë, pasi ai konfirmon se vetë Autoriteti Kontraktues ka pranuar ekzistimin e gabimeve materiale në dokumentacionin e tenderit.

Pretendimi Ankimor 6.

Për më tepër, konsiderojmë se në rastin konkret ekziston bazë e plotë ligjore që Organi Shqyrtues i Prokurimit të vendosë anulimin në tërësi të këtij aktiviteti të prokurimit. Kjo për faktin se nuk kemi të bëjmë me një lëshim formal apo me një parregullsi të natyrës teknike, por me shkelje materiale që kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmblajtjen e dokumentacionit të tenderit, në përgatitjen e ofertave nga operatorët ekonomikë dhe në zhvillimin e ligjshëm të procedurës së prokurimit.

Vetë Autoriteti Kontraktues, me vendimin e datës 26.03.2026, ka pranuar se dokumentacioni i tenderit përmblote gabime materiale dhe për këtë arsye kishte vendosur anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Po ashtu, nga komunikimi zyrtar elektronik i datës 25.03.2026 rezulton se zyrtarët e Autoritetit Kontraktues kanë pranuar shprehimisht ekzistimin e gabimeve në Paramasë dhe Paralogari.

Këto fakte përbëjnë pranim zyrtar të mangësive nga vetë Autoriteti Kontraktues dhe nuk mund të injorohen gjatë shqyrtimit të kësaj ankese.

Në këto rrethana, vazhdimi i procedurës së prokurimit, pavarësisht pranimi të gabimeve materiale nga vetë Autoriteti Kontraktues, është në kundërshtim me parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik, përkatësisht me parimin e ligjshmërisë, transparencës, trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, proporcionalitetit, konkurrencës së ndershme dhe sigurisë juridike.

Prandaj, çdo vendim për vazhdimin e kësaj procedure është juridikisht i paqëndrueshëm, pasi është mbështetur mbi një dokumentacion që vetë Autoriteti Kontraktues e ka pranuar se ka qenë i pasaktë.

Nëse një procedurë e tillë do të lejohej të vazhdonte, do të legjitimohej një proces prokurimi i zhvilluar mbi dokumentacion me gabime materiale, gjë që bie ndesh me qëllimin e Ligjit për Prokurimin Publik dhe cenon besimin e operatorëve ekonomikë në zhvillimin e procedurave të drejta dhe të ligjshme.

Për rrjedhojë, duke pasur parasysh natyrën dhe peshën e shkeljeve të konstatuara, si dhe faktin se ato janë pranuar nga vetë Autoriteti Kontraktues, i propozojmë Panelit Shqyrtues të Organit Shqyrtues të Prokurimit që, në ushtrimin e kompetencave të tij ligjore, ta aprovojë këtë pretendim ankimor dhe të vendosë anulimin në tërësi të aktivitetit të prokurimit, pasi ky është i vetmi mjet juridik efektiv për rivendosjen e ligjshmërisë dhe garantimin e trajtimit të barabartë të

të gjithë operatorëve ekonomikë.

Nga të gjitha faktet, provat materiale dhe argumentet juridike të paraqitura në këtë ankesë, rezulton qartë se Autoriteti Kontraktues ka zhvilluar procedurën e prokurimit në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, Rregullores për Prokurimin Publik, Udhëzimeve Administrative dhe kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Gjatë procedurës së vlerësimit, Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për dhënie të kontratës një operator ekonomik që nuk i plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat ligjore gjatë shqyrtimit të ofertave dhe ka lejuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që nuk kanë përmbushur kërkesat administrative dhe teknike të procedurës.

Po ashtu, pavarësisht se Operatori Ekonomik ankues ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të mbështetur në prova konkrete dhe argumente juridike, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar atë pa dhënë arsytim të mjaftueshëm ligjor dhe pa shqyrtuar në mënyrë individuale secilin prej pretendimeve ankimore, duke vepruar në kundërshtim me nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik.

Një vendim i tillë nuk i përmbush standardet e arsytimit administrativ dhe cenon të drejtën e operatorit ekonomik për një mjet juridik efektiv.

Për më tepër, nga provat e bashkëngjitura rezulton se vetë Autoriteti Kontraktues ka pranuar ekzistimin e gabimeve materiale në dokumentacionin e tenderit, përkatësisht në Paramasë dhe Parallogari, gabime të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në përgatitjen e ofertave dhe në trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

Në këto rrethana, vazhdimi i procedurës së prokurimit cenon parimet themelore të ligjshmërisë, transparencës, trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe konkurrencës së ndershme, të garantuara me Ligjin për Prokurimin Publik.

Duke qenë se shkeljet e evidentuara janë të natyrës materiale dhe procedurale, të njëjtat kanë ndikuar në ligjshmërinë e tërë procedurës së prokurimit dhe nuk mund të konsiderohen si lëshime formale të parëndësishme.

Për rrjedhojë, vendimi i Autoritetit Kontraktues për dhënien e kontratës është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe nuk mund të prodhojë efekte juridike.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për KRASNIQI SERVICE SH.P.K.,:

Autoriteti Kontraktues, pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim të paraqitur nga Operatori Ekonomik KRASNIQI SERVICE SHPK, lidhur me aktivitetin e prokurimit me nr. 635-26-318-2-1-1, konstaton se kërkesa është e pabazuar për arsyet në vijim: Në zbatim të Vendimeve të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), Autoriteti Kontraktues e ka kthyer lëndën në rivlerësim nga pika zero, duke zhvilluar një proces të ri të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe vendimet e OSHP-së. Gjatë këtij procesi të rivlerësimit, të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës u është kërkuar vazhdimi i vlefshmërisë së ofertave dhe sigurimit të tenderit. Si rezultat, tre (3) operatorë ekonomikë kanë vazhduar në afat vlefshmërinë e ofertave dhe sigurimin e tenderit, duke ruajtur statusin e tyre si ofertues të përgjegjshëm për vazhdimin e procedurës. Komisioni për rivlerësim ka bërë

shqyrtimin e ofertave vetëm të operatorëve ekonomikë që kanë përmbushur këtë kërkesë dhe ka zhvilluar procesin e vlerësimit në përputhje me nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe dispozitat përkatëse të Rregullores për Prokurimin Publik. Pas përfundimit të rivlerësimit, komisioni ka konstatuar se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës është ai që ka paraqitur ofertën e përgjegjshme me çmimin më të ulët, duke përmbushur të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe kriteret e përcaktuara për dhënie të kontratës. Pretendimet e Operatorit Ekonomik KRASNIQI SERVICE SHPK se Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar vendimet e OSHP-së nuk qëndrojnë, pasi rivlerësimi është zhvilluar nga fillimi, në përputhje me urdhërimet e OSHP-së dhe legjislacionin në fuqi. Fakti që gjatë procedurës kanë mbetur në konkurrim vetëm operatorët ekonomikë që kanë vazhduar vlefshmërinë e ofertave dhe sigurimin e tenderit nuk përbën shkelje të Ligjit për Prokurimin Publik, por është rezultat i respektimit të kërkesave ligjore dhe procedurale. Po ashtu, pretendimet e parashtruesit lidhur me vlerësimet e bëra në fazat e mëparshme të procedurës nuk ndikojnë në ligjshmërinë e rivlerësimit aktual, pasi lënda është trajtuar nga fillimi dhe komisioni rivlerësues ka marrë vendimin e tij mbi bazën e dokumentacionit, ofertave të vlefshme dhe gjendjes faktike në momentin e rivlerësimit. Prandaj, Autoriteti Kontraktues vlerëson se kërkesa për rishqyrtim nuk përmban argumente apo prova që do të dëshmonin shkelje të Ligjit për Prokurimin Publik apo të dispozitave të Dosjes së Tenderit gjatë procesit të rivlerësimit.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për SEFERI- MONT SH.P.K.,:

Pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim të paraqitur nga Operatori Ekonomik SEFERI MONT SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit nr. 635-26-318-2-1-1, Autoriteti Kontraktues konstaton se kërkesa është e pabazuar. Autoriteti Kontraktues sqaron se gjatë procesit të rivlerësimit ka vepruar në përputhje të plotë me Vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), Ligjin për Prokurimin Publik, Rregulloren për Prokurimin Publik, si dhe me kërkesat e Dosjes së Tenderit. Lënda është kthyer në rivlerësim nga pika zero, ku komisioni i rivlerësimit ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave në mënyrë të paanshme dhe vetëm mbi bazën e dokumentacionit të tenderit dhe kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Gjatë këtij procesi, Autoriteti Kontraktues u ka kërkuar operatorëve ekonomikë vazhdimin e vlefshmërisë së ofertave dhe sigurimit të tenderit. Vetëm operatorët ekonomikë që kanë përmbushur këtë kërkesë kanë vazhduar të jenë pjesë e procedurës së rivlerësimit. Komisioni i rivlerësimit ka konstatuar se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës i plotëson të gjitha kërkesat administrative, profesionale dhe teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe, njëkohësisht, ka paraqitur ofertën me çmimin më të ulët. Pretendimet e Operatorit Ekonomik SEFERI MONT SH.P.K. nuk mbështeten në prova që dëshmojnë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik apo me Dosjen e Tenderit. Përkundrazi, i gjithë procesi i rivlerësimit është zhvilluar në përputhje me dispozitat ligjore dhe kërkesat e dokumentacionit të tenderit. Autoriteti Kontraktues nuk ka devijuar nga kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe nuk ka aplikuar kritere shtesë apo diskriminuese gjatë vlerësimit të ofertave. Të gjithë operatorët ekonomikë janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe sipas të njëjtave kritere të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit. Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues vlerëson se pretendimet e Operatorit Ekonomik SEFERI MONT SH.P.K. janë të pabazuara dhe nuk përbëjnë bazë ligjore për ndryshimin e Vendimit mbi dhënien e kontratës. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik SEFERI MONT SH.P.K.

Raportin e ekspertizës me nr.0529/2026 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndersa OE është pajtuar

rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Raportin e ekspertizës me nr.0539/2026 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, po ashtu as OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, parashtruesat dhe dokumentet e ankuesve, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE KRASNIQI SERVICE SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0529 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: OE ankues ka parashtruar për herë të tretë ankesë pranë OSHP-së në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, duke ngritur pretendime ankimore të cilat janë shqyrtuar nga eksperti shqyrtues dhe i njëjti sipas mendimit të tij ka dhënë përgjigje si më poshtë.

Pretendimi 1

“Ky aktivitet përmbanë katër vendime të marra nga AK, së pari është rekomanduar për kontratë OE Seferi Mont, ndërsa Gentian Sakaj B.I. është eliminuar për arsye të mos plotësimit të kërkesave të dosjes, pasi që kemi paraqitur ndërhyrjet në paramasë nga ana e OE të rekomanduar, AK ka anuluar këtë procedurë. Me ankesën e bërë në OSHP, lënda është kthyer në rivlerësim ku AK ka eliminuar të gjithë operatorët ekonomik, edhe në arsyen e kërkesave të cilat nuk kanë ekzistuar fare në dokumentet e tenderit. Asnjëri nga operatorët pjesëmarrës nuk kanë ushtruar të drejtën e ankimit në lidhje me vendimet e marra nga AK. Në pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, përsëri kemi bërë ankesë në OSHP ku është aprovuar kërkesa jonë nga OSHP dhe lënda është kthyer në rivlerësim dhe pas rivlerësimit është rekomanduar për kontratë një operator i cili vazhdimisht është pajtuar me vlerësimet dhe konstatimet e autoritetit kontraktues duke mos ushtruar asnjë mjet juridik për kundërshtimin e tyre.”

Përgjigje

Eksperti shqyrtues sqaron që kjo është ankesa e tretë e cila pranohet në Organin Shqyrtues të Prokurimit, e parashtruar nga i njëjti operator ekonomik. Me vendimin e fundit të lëshuar nga Paneli Shqyrtues lënda është kthyer në rivlerësim për herën e dytë dhe pas rivlerësimit, AK ka rekomanduar për kontratë një operator tjetër ekonomik i cili ka çmimin më të ulët por që me vendimet e lëshuara më parë nga AK i njëjti është eliminuar për arsye të caktuara dhe vetëm me vendimin e fundit ky operator është rekomanduar për kontratë.

Sqarojmë që sipas evidencës në sistemin e-prokurimi, OE i rekomanduar për kontratë shihet se vetëm njëherë ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim në kuadër të Autoritet Kontraktues me datë 21/03/2026 dhe pas kësaj kërkesë ky operator nuk ka atakuar më asnjë vendim tjetër të publikuar

nga ana e AK-së as me kërkesë për rishqyrtim dhe as me ankesë në OSHP. Në rastin konkret ekspertit sipas mendimit të tij sqaron që arsyet për të cilat është eliminuar OE i rekomanduar më herët janë atakuar vetëm pranë Autoritetit Kontraktues mirëpo sipas përgjigjes së AK-së lënda është kthyer në rivlerësim sa i përket gabimeve në paramasën e evidentuar dhe jo për shkak të pretendimeve të tjera të pranuar nga OE ankues, ku pas kësaj AK ka nxjerrur vendim për anulimin e tenderit. Pra, vetëm pas atakimit të vendimit për anulim dhe pas kthimit të lëndës në rivlerësim me vendimin e OSHP-së, AK nga operator i eliminuar ka nxjerrur vendim për rekomandim si i përgjegjshëm për të njëjtin operator, arsyet e eliminimit të të cilit nuk janë shqyrtuar asnjëherë dhe për to nuk është dhënë përgjigje as në kuadër të autoritetit kontraktues dhe as nga OSHP. Megjithatë, sqarojmë që duke marrë parasysh që OSHP ka pranuar edhe një ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit, ku janë ngritur edhe pretendime për OE i rekomanduar dhe pas shqyrtimit të tyre sipas mendimit të ekspertit në raportin tjetër kemi sqaruar që OE i rekomanduar nuk i ka përmbushur tërësisht kërkesat e dosjes së tenderit sa i përket kontratave të ngjashme në tre vitet e fundit përkatësisht dokumentit të dorëzuar si referencë për kontratën e fundit nga lista e kontratave, megjithatë mbetet në diskrecionin e Autoritetit Kontraktues verifikimi i tyre sipas nenit 52.7 të LPP-së.

Sipas mendimit tonë vlerësojmë që rasti se kur duhet të merren parasysh të gjithë operatorët ekonomik me pranimin e një ankesë dhe kthimit të lëndës në rivlerësim është rasti kur të gjithë operatorët ekonomik eliminohen për një arsye të njëjtë e cila më pas nga OSHP sqarohet se nuk konsiderohet arsye e eliminimit dhe në rastin e tillë konform nenit 7 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) të gjithë operatorët për arsye të njëjta të eliminimit duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë pa marrë parasysh parashtrimin të ankesave apo jo nga ana e atyre operatorëve. Nga sqarimet e bëra më lartë vlerësojmë që pretendimi i ngritur nga ana e OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimet e OE SEFERI- MONT SH.P.K., ekspertit shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0539 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: Eksperti shqyrtues fillimisht sqaron që për këtë aktivitet të prokurimit është hera e tretë që OSHP pranon ankesë nga operatorë ekonomik, ndërsa është hera e parë që një ankesë pranohet nga ky operator ekonomik edhe pse edhe më herët kanë ekzistuar edhe tre vendime të tjera të autoritetit kontraktues. Mirëpo, unë jam autorizuar si ekspert për shqyrtimin e kësaj anekese dhe sipas nenit 113 dhe 114 të Ligjit për Prokurimin Publik kam shqyrtuar pretendimet e ngritura me ankesën e pranuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Pretendimi 1

“OE i rekomanduar nuk ka përfunduar me sukses kontrata për projekte të ngjashme gjatë tre viteve të fundit në vlerë minimale prej 130,000.00 euro. Edhe vet AK ka konstatuar se disa kontrata si ajo me Policinë e Kosovës dhe Komunen e Dragashit nuk kanë qenë në përputhje të plotë me kërkesat e dosjes.”

Eksperti shqyrtues sqaron që në dosjen e tenderit ndër të tjera është kërkuar edhe që operatorët pjesëmarrës të kenë të përfunduara kontrata të ngjashme në tre vitet e fundit në vlerë prej 130,000.00 euro dhe si dëshmi të dorëzohen referencat, procesverbalet për kryerjen e punëve ose pagesat bankare në rastin e sektorit privat. OE i rekomanduar në ofertën e tij ka dorëzuar listën e kontratave dhe disa dëshmi përkatëse referenca, disa fatura dhe qarkullimin nga banka si dëshmi e pagesave të faturave.

Sqarojmë që edhe nëse të gjitha faturat e dorëzuara në ofertë nga OE i rekomanduar pranohen përfshirë edhe referencat dhe pranimet teknike, përsëri pa referencën e fundit konsiderojmë që nuk arrihet shuma e kërkuar përmes FDT-së. Sipas mendimit të ekspertit shqyrtues referenca e fundit me komunën e Dragashit në shumën prej 60,000.00 euro nuk është e pranueshme për arsye që edhe pse sipas referencës kontrata ka përfunduar para kohës së paraparë sipas mendimit të ekspertit shqyrtues prapë kjo referencë nuk mund të konsiderohet tërësisht si një dokument valid për arsye se edhe pse është lëshuar nga një institucion publik, e njëjta përmbanë vetëm një nënshkrim dhe një vulë rrethore por jo edhe një vulë të protokollit siç do të duhet të kishte çdo dokument zyrtar i lëshuar nga institucionet publike për të bërë të vlefshëm këtë dokument zyrtar, megjithatë vlerësojmë që mbetet në diskrecion të Autoritetit Kontraktues që të verifikoj këtë dokument në bazë të nenit 52.7 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Pasqyrojmë që edhe kontrata e parë sipas listës së kontratave ka të bëjë me furnizim siç pretendohet nga ankesa dhe e cila vlerësojmë që nuk është në përputhje me kriterin e dosjes së tenderit për kontrata të ngjashme.

Tutje sqarojmë që mosplotësimi i këtyre kërkesave është dhënë më herët edhe nga ana e Autoritetit Kontraktues si arsye e eliminimit për OE i rekomanduar dhe AK ka pranuar një kërkesë për rishqyrtim por që arsyetimi nuk është i pranuar nga ana e AK-së sepse kthimi i lëndës në rivlerësim është bërë për shkak të gabimeve në paramasë dhe jo për shkak të pretendimeve të ngritura, OE i rekomanduar më pas edhe pas publikimit të vendimeve të tjera nga ana e AK-së, kur janë përsëritur arsyet e njëjta të eliminimit, i njëjti nuk ka vazhduar me ankesa të tjera as si kërkesa për rishqyrtim dhe as në organet e tjera që konsiderojmë që këto arsye të eliminimit asnjëherë nuk janë shqyrtuar nga organet kompetente. Nga sqarime e bëra më lartë vlerësojmë që ky pretendim i ngritur nga ana e OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi 2

“OE i rekomanduar ka paraqitur si dëshmi një kontratë e cila është nënshkruar nga i njëjti person në cilësinë e të dyja palëve kontraktuese. Ky dokument nuk mund të konsiderohet i vlefshëm për qëllime të dëshmimit të përvojës së ngjashme dhe madje këtë gjë e ka pranuar edhe vet AK.”

Në lidhje me kontratën e dorëzuar për vet pronarin e operatorit ekonomik i cili po ashtu paraqitet edhe si punonjës sqarojmë që OE i rekomanduar shihet se në rastin konkret ka dashur që të veprojë në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit, por në këto raste mendimi i ekspertit shqyrtues është se në rastin kur vet pronari i operatorit është specialist i një pozite të caktuar atëherë mjafton që pronari të paraqitet si punëtor së bashku me profesionin e kërkuar në listën e stafit e cila dorëzohet me ofertë, ndërsa vlerësojmë që në rastin e tillë nuk ka nevojë që të dorëzohet edhe kontrata e punës sepse kjo gjë mund të dëshmohet përmes certifikatës së biznesit dhe dëshmive të tjera të cilat mund të dorëzohen me rastin e vlerësimit të përvojës së punës. Konsiderojmë që ky pretendim i ngritur është i pabazuar.

Pretendimi 3

“Mos plotësimi i formularit për vazhdimin e validitetit të ofertës nga OE Krasniqi Service. Në pikën 5 të formularit për vazhdimin e validitetit OE nuk e ka deklaruar shumën fikse të sigurimit të ofertës prej 15,000.00 euro dhe sipas udhëzuesit në këtë rast refuzohet tenderi. Po ashtu, në pikën 6 të të njëjtit formular ky OE nuk e ka deklaruar nacionalitetin e tij, ndonëse kjo fushë është pjesë obligative. AK plotësimin e formularit C i cili gjendet në DT e ka kërkuar nga secili operator përmes kërkesës të dorëzuar për vazhdimin e validitetit të ofertës dhe sigurimit.”

Eksperti shqyrtues sqaron që pika në të cilën është thirrur OE ankues sa i përket formularit të tenderit ka të bëjë me fazën e dorëzimit të tenderit dhe ky formular gjenerohet automatikisht nga ana e sistemit e-prokurimi dhe nuk ka të bëjë me vazhdimin e validitetit të ofertave, përkatësisht referimi tek pika 10 e Udhëzuesit për Prokurimin Publik. Kërkesa e AK-së sa i përket vazhdimin të validitetit duke plotësuar Formularin C të dosjes së tenderit dhe pretendimet e mungesës së plotësimit të informatave të caktuara në këtë formular sipas mendimit tonë sqarojmë që nuk janë në përputhje me rregullat e prokurimit publik.

Siç mund të shihet edhe nga Pjesa C: Formular për dorëzimin e tenderit, tek pjesa e shënimit sqarohet që ky formular kërkohet vetëm në rastin kur tenderi dorëzohet në kopje fizike sepse në formën elektronike ky formular krijohet përmes sistemit dhe madje sqarojmë edhe njëherë që ky formular kërkohet me rastin e dorëzimit të tenderit dhe jo vazhdimin të validitetit apo sigurimit të tenderit. Pra, AK nuk mund të shtoj kërkesa jashtë atyre të paraqitura në NJK dhe DT dhe gjithashtu nuk konsiderojmë që mund të shtoj kërkesa të cilat janë jashtë rregullave të përcaktuara me ligjin dhe rregulloren e prokurimit publik. Nga përgjigja e dhënë vlerësojmë që ky pretendim i ngritur nga ana e OE ankues është i pabazuar.

Pretendimi 4

“OE ankues ka dorëzuar vetëm një deklaratë lidhur me pikën 9.1.5 të FDT-së, mirëpo nuk ka dorëzuar Aneksin1- Specifikimet Teknike të Detyrueshme, i cili ishte pjesë integrale e dosjes së tenderit dhe dokument i detyrueshëm për t’u plotësuar. Pra, mos dorëzimi i aneksit 1 do të thotë që OE nuk ka pranuar në mënyrë formale obligimin se gjatë periudhës së kontratës prej 24 muajsh do të realizoj servisimin dhe liferimin brenda afatit maksimal prej 10 ditësh nga data e pranimit të çdo urdhërblere.”

Eksperti shqyrtues pasqyron që kjo çështje për këtë aktivitet të prokurimit tashmë është çështje e shqyrtuar më herët nga eksperti shqyrtues dhe për të ka edhe një vendim të panelit shqyrtues, vendimi me nr.2026/0336. Sa i përket liferimit dhe afatit po ashtu sqarojmë që ky kriter nuk ka qenë pjesë e FDT-së, dhe sipas nenit 56, pika 3 e LPP-së një tenderues nuk duhet të eliminohet për shkak të kërkesave të cilat paraprakisht nuk kanë qenë pjesë e Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit. Vlerësojmë që ky pretendim i ngritur është i pabazuar.

Pretendimi 5

“AK me vendim të datës 26/03/2026 kishte anuluar aktivitetin e prokurimit në fjalë si rezultat i konstatimeve të gabimeve në dokumentacionin e tenderit konkretisht në paramasë dhe parallogari. Ekziston edhe një komunikim zyrtar përmes postës elektronike ndërmjet zyrtarëve të AK-së në të cilën konfirmohen qartë gabimet.”

Në lidhje me pretendimin e ngritur sqarojmë që kjo çështje tashmë është shqyrtuar nga ana e Organit Shqyrtues të Prokurimit qysh herën e parë, me rastin e pranimit të ankesës së parë për këtë aktivitet të prokurimit dhe për të ka një raport të ekspertit dhe gjithashtu edhe një vendim të Panelit Shqyrtues me nr. 2026/0216. Po ashtu, sqarojmë që OE ankues këtë aspekt të ngritur sipas LPP-së e ka pasur mundësinë për të ngritur në fazën e duhur të paraparë me nenin 108/A të LPP-së. Vlerësojmë që ky pretendim i ngritur nga ana e OE ankues është i pabazuar.

Pretendimi 6

“Ekziston bazë e plotë ligjore që Organi Shqyrtues i Prokurimit të vendosë anulimin në tërësi të këtij aktiviteti të prokurimit. Sepse nuk kemi të bëjmë me një lëshim formal por me shkelje materiale dhe për këtë arsye kishtë vendosur anulimi i aktivitetit të prokurimit.”

Sqarojmë që edhe për këtë pretendim vlenë përgjigja e dhënë në pretendimin paraprak që për asryen e cekur nga operatori ankues ka shqyrtim paraprak nga ana e OSHP-së.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit, konsideron se gjetjet e raportit të ekspertit shqyrtues vlerësimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatoreve ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues, andaj paneli shqyrtues pa nevojë për sqarime tjera shtesë e vlerëson si të bazuara ankesat e OE ankuesve të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhenie të kontrates, ndërkaq aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik KRASNIQI SERVICE SH.P.K., të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Mirëmbajtja dhe Servisimi i automjeteve (veturave) zyrtare të SHCK-së në Komunën e Pejës me numër të prokurimit 635-26-318-2-1-1, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si të bazuar, duke sugjeruar që aktiviteti i prokurimit ne fjalë të rivlerësohet dhe gjatë rivlerësimit AK të veprojnë në plotin me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish

në ri-vlerësim.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik SEFERI- MONT SH.P.K., aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Mirëmbajtja dhe Servisimi i automjeteve (veturave) zyrtare të SHCK-së në Komunën e Pejës me numër të prokurimit 635-26-318-2-1-1, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PEJES, KOMUNA E PEJES**
- **OE - KRASNIQI SERVICE SH.P.K., "SEFERI- MONT" SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: